

Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (16)

Cila është porosia e konflikteve të ish-Jugosllavisë

Milosheviqi ka rënë, por jo edhe idetë nacionaliste brenda Serbisë. Serbët duhet të mësojnë nga dështimi i Milosheviqit

Pas dy luftërave të humbura, ekonomisë së shkatërruar dhe bashkimit të forcave të opozitës brenda Serbisë, koncepti i ringjalljes serbe serb u mposht, më në fund, siç u mposht edhe vetë Milosheviqi. Mirëpo, përpjekjet

për ta krijuar një shtet për të qenë nuk kishin sukses edhe pas rënies së Milosheviqit - për shkak të nacionalizmit serb. Idetë dhe konceptet për ringjalljen serbe vazhdojnë të qarkullojnë në popullatën serbe dhe kjo dëshmohe

më së miri me numrin e madh të votave të Partisë Radikale Serbe. A është njësoj edhe në Kroaci? Të paktën liderët kroatë, edhe ata më ekstremët, e kanë heshtur retorikën e tyre ekspansioniste. Mirëpo, në këtë fejton nuk është shtruar çështja e disfatës së serbëve. Në këtë fejton është shtruar çështja e karakterit të lëvizjes serbe të ringjalljes dhe së këndejmi nuk mund të bëhen krahasime as me Kroacisë, as me Bosnjën e as me Slloveninë.

Mirëpo, cila është rëndësia që të kuptohet lëvizja serbe e ringjalljes?

Së pari, kjo ndihmon që të kuptohen lëvizjet nacionaliste si mekanizma për zbutjen e stresit. Së dyti, ndihmon të kuptohet se si nacionalizmi ndikon në ndërrimin e perceptimit dhe të sjelljes së shoqërisë. Së treti, nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet “ngazëllimit ekstrem emocional” të krtijuar nga mobilizimi nacionalist. Së katërti, mobilizimi nacionalist lë të kuptohen sjelljet e liderit nacionalist, i cili

trajtohet si lider kulti që ka të drejta ta bëjë e ta shkelë ligjin. Së pesti, e gjithë kjo tregon se në një shoqëri ka nevojë për deprogramim. Nëse nuk do të ketë deprogramim një shoqëri, atëherë do të ketë pasoja edhe për brezat e ardhshme të saj.

(Në numrin e ardhshëm: Si e kanë kuptuar shtetin shumica e politikanëve serbë? A ka qenë i pashmangshëm konflikti në Jugosllavi? Pse e vrisnin fqinjët njëri-tjetrin?)



Pas disa luftërash të humbura, ekonomisë së shkatërruar dhe bashkimit të opozitës, Slobodan Milosheviqi dhe politika e tij pësuan disfatë përfundimisht

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Perović. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (2)

Fëmijëria ndërmjet gjirit të nënës dhe kishës së Shën Mikelit

I përjashtuar nga shkolla pasi ia kishte dhënë nja dy-tri grushte e shkelma mësueses, Alphonso Capone sillej vërdallë rrugëve. Në këtë kohë ai do të takohej me dy njerëzit më të rëndësishëm të jetës së tij, gruan e tij të ardhshme Mae dhe gangsterin xhentëlmen Johnny Torrio

Gabriele dhe Teresina Capone ishin emigrantë italianë, prindër të nëntë fëmijëve dhe bënë jetë të qetë e të ndershme në kuartin Brooklyn në New York. Pak pasi u kishte lindur djali katërt, Alphonsoja, familja ishte zhvendosur në një banesë më të mirë, ndërsa Gabriele e kishte hapur një dyqan ku ushtronte zanatin e tij të berberit. Në lagjen e tyre jetonin kryesisht irlandezë, por kishte edhe emigrantë gjermanë, suedezë dhe kinezë.

Jo shumë larg banesës së familjes Capone ishte kisha e Shën Mikelit.

Ndërmjet banesës së tij dhe kishës ishte rritur Al Capone. Ishte rritur në lojën me fëmijët e tjerë të lagjes dhe me shokët e shkollës. Nuk ishte nxënës i keq. Mirëpo, shkolla ishte e dobët. Mësueset ishin kryesisht të reja dhe të paarsimuar sa duhet. Përkthyer në sistemin arsimor të Kosovës, Al Capone ishte nxënës shumë i mirë (jo i shkëlqyeshëm) deri në klasën

e gjashtë, kur kishte nisur të merete nota më të dobëta. Mirëpo, kthesë e vërtetë në shkollimin e tij u bë në moshën 14-vjeçare. Një mësuese e re i kishte humbur nervat dhe e kishte flakareshur Alphonson, djalosin e ri të emigrantëve italianë. Po të kishte ndodhur kjo flakareshë disa vjet më vonë, mësuesja do të ishte “duke fjetur me peshqit”. Mirëpo, si 14-vjeçar e tëra që mund të bënte Alphonsoja ishte t’ia kthente dorën mësueses. Ia dha



Johnny Torrio

nja dy a tre grushte e shkelma dhe pastaj e përjashtuan nga shkolla. Alphonsoja më kurrë nuk shkoi në shkollë. Mirëpo, në këtë kohë, djaloshi i ri do të takohej në mëhallë me dy personat, të cilët do të kishin rolin më të madh në jetën e tij: gruan e tij të ardhshme, Mae dhe gangsterin Johnny Torrio. Gangsteri Johnny Torrio ishte një ndër “shefat” më të frikshëm të New Yorkut. Shtabi i tij gjendej jo larg banesës së familjes Capone. Torrio ishte një ndër pionierët e organizatave bashkëkohore të kimit. Ai merrej me reket, por dinte si të organizonte gjëra. Nga miqësia me Torrior, Capone i ri i ka mësuar shumëçka.

Torrio në shikim të parë nuk do t’ia mbushte syrin asnjëriu. Ishte i shkurtër dhe thatim. Mirëpo, ishte aq i zgjuar se ta kuptonte se për të mbretëruar në rrugë nuk duhen muskuj sa duhet mençuri. Falë mençurisë ai ia kishte dalë të krijonte një reputacion të hatashëm. Torrio vishej si zotëri dhe nuk linte përshtypjen se bën reket dhe se është pronar i bordeleve dhe i kurvave. Të rinjtë e mëhallës e adhuronin. Capone, i përjashtuar nga shkolla, sillej vërdallë rrugëve dhe ndonjëherë e kryente ndonjë punë postieri për

Gangsterë të tjerë të shquar

John Dillinger

John Dillinger, ose siç e quanin “xhentëlmeni John”, konsiderohet njëri ndër kriminelët më të rrezikshëm të kohës së tij. Ka qenë bashkëkohanik i Al Capones. Ka qenë plaçkitës bankash dhe vrasës. Si djalë i ri 17-vjeçar e kishte plaçkitur dyqanin e parë dhe që atëherë nuk ishte ndalur derisa ka vdekur. Është arrestuar në janar të vitit 1934 për vrasjen e një polici gjatë plaçkitjes së një banke në Chicago. Mirëpo, me një revole të drunjtë e ka vrarë rojën e burgut dhe ia ka dalë të ikte. Disa muaj më pas, pasi i kishte kryer edhe shumë krime të tjera, më 22 korrik të vitit 1934, Johnny Dillinger është vrarë nga agjentët e FBI-së në qendër të Chicagos. Ishte tradhtuar nga e dashura e tij, Anna Sage. Anna atë natë kishte pasur të veshur një fustan të kuq dhe që atëherë ka hyrë në modë fraza “Lady in Red” (Zonja me të kuqe”. Dillinger ka qenë vetëm 31 vjeç kur ka ndërruar jetë.

Torrior, duke e fituar kështu ndonjë cent. Mirëpo, duke kryer punë të vogla, Al Capone “vidhte” zanatin e punëve të mëdha. Veç kësaj, ishte djalë i fuqishëm, më i fuqishëm se të gjithë shokët e tij.

(Në numrin e ardhshëm: Për çka kishte më së shumti talent Alphonso Capone i ri? Cilat ishin mësimet nga Johnny Torrio? Kush ishte gangsteri tjetër që i la mbresa Alphonso të ri? Si u afrua Al Capone më shumë me Johnny Torrior?)

